

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
Dhjetor 2025

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	27.11.2025	Sa është fondi i përcaktuar për familjet të cilat kanë përfituar nga fondi i emergjencave civile shkak për të cilën janë bërë fatkeqsitë natyrore si: tërmetet, zjarret dhe përmbytjet, gjatë 6 viteve të fundit, periudha 2019-2025? Sa nga ky fond i përcaktuar është shpërndarë? Sa nga ky fond i përcaktuar është shpërndarë? Sa familje janë identifikuar si të dëmtuara dhe përfituese të këtij fondi? A ekziston një listë e familjeve përfituese, nëse po, lutëmi të na vini në dispozicion. Cilat janë bashkitë që kanë pasur më shumë raste të familjeve të dëmtuara? MCN	12.12.2025	Përsëndetje Znj. N., Në vijim gjeni informacionin e kërkuar. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligji nr. 45, datë 18.7.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, si dhe Urdhri i Kryeministrit nr. 27, datë 3.2.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, si strukturë përgjegjëse për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. AKMC është person juridik publik qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile	e plote	nuk ka

			dhe përgjigjet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. AKMC ushtron autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile. Qëllimi i Mbrojtjes Civile është zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe realizimi i mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të Mbrojtjes Civile, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve dhe të strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin.	
--	--	--	--	--

				1. Sa është ë fon di i përc akt uar për fam iljet të cilat kan ë përf itua r nga fon di i eme rgje nca ve civil e shk ak për të cilë n janë bër ë fatk eqsi të nat yror e si: tër met et, zjar ret dhe për mby tjet,	
--	--	--	--	---	--

				gjat ë 6 vite ve të fun dit, peri udh a 201 9- 202 5? Në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, financimi i menaxhimit të emergjencave civile në Republikën e Shqipërisë mbështetet në fondet e dedikuara nga buxheti i shtetit dhe përdoret për të mbuluar të gjithë ciklin e emergjencave civile, përfshirë parandalimin, gatishmërinë, reagimin, rehabilitimin dhe rimëkëmbjen. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) ka filluar aktivitetin ekonomik në zbatim të Urdhrit nr. 27, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organizatës së AKMC-së”, duke u	
--	--	--	--	--	--

			bërë plotësisht funksionale nga muaji gusht 2020. Buxheti i AKMC-së, me rishikimet përkatëse, paraqitet si më poshtë vijon: Viti 2020 - Buxheti 52.262.000 lekë. Viti 2021- Buxheti 352.667.000 lekë. Viti 2022- Buxheti 1.485.932.000 lekë. Viti 2023- Buxheti 2.383.794.000 lekë. Viti 2024- Buxheti 3.238.561.000 lekë. Viti 2025- Buxheti 2.440.467.000 lekë. Gjithashtu, në përputhje me aktet nënligjore të dala në zbatim të Ligjit nr. 45/2019, njësitet e vetëqeverisjes vendore luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e emergjencave civile. Ato përfitojnë fonda të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, të cilat përdoren posaçërisht për: - parandalimin dhe reduktimin e rreziqeve në nivel vendor;	
--	--	--	--	--

			- rritjen e kapaciteteve të gatishmërisë dhe reagimit; - kompensimin e qytetarëve të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore, në rastet dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Ky mekanizëm siguron që kompensimi i familjeve të prekura nga fatkeqësitë — përfshirë tërmetet, zjarret dhe përmytjet — të kryhet nga njësitet e qeverisjes vendore, sipas detyrimeve dhe kompetencave të përcaktuara në ligj. 2. Sa nga ky fond i përcaktuar është shpërndarë? Fondi i akorduar për Njësitet e Vetëqeverisjes Vendore, në zbatim të ligjeve vjetore të buxhetit, si dhe të VKM nr.	
--	--	--	--	--

				329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, si edhe të VKM nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”, të ndryshuar, administrohet dhe shpërndahet nga vetë Njësitë e Pushtetit Vendor, sipas procedurave të përcaktuara. 3. A është përcaktuar afat për pjesën e pasqepërndarë të	
--	--	--	--	--	--

				fon dit? Fondet e akorduara nga AKMC, në formë të transfertës së kushtëzuar, në zbatim të udhëzimeve standard të zbatimit të buxhetit, nuk mund të mbarten në vitin pasardhës nëse mbeten të papërdorura në fund të vitit buxhetor. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore duhet të marrin masat e nevojshme për përdorimin e këtij fondi për Mbrojtjen Civile brenda të njëjtit vit buxhetor, në përputhje me specifikimet e VKM nr. 414, datë 08.07.2021. Fondi duhet të shfrytëzohet për të mbuluar të gjithë ciklin e emergjencave civile, duke përfshirë parandalimin, gatishmërinë, reagimin, rehabilitimin dhe rimëkëmbjen.. 4. Sa fam ilje janë iden	
--	--	--	--	--	--

				tifikuar si të dëmtuara dhe përfituese të këtij fondi? Në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe të praktikave të ndjekura për kompensimin financiar të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, rezulton se gjatë viteve 2021–2024 janë identifikuar dhe kompensuar gjithsej 3,011 shtetas/familje, si më poshtë: • Viti 2021: 769 përfitues • Viti 2022: 1,236 përfitues • Viti 2023: 0 përfitues (në mungesë të fondeve të akorduara për kompensim) • Viti 2024: 1,006 përfitues Këto familje janë identifikuar nga Njësitë e Vetëqeverisjes	
--	--	--	--	--	--

				Vendore, në përputhje me procedurat e përcaktuara në VKM nr. 329, datë 16.05.2012 dhe VKM nr. 414, datë 08.07.2021. 5. A ekziston një listë e familjeve të përfituese, nëse po, lutëmi të na vini në dispozicion. Listat e familjeve të përfituese administrohen nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të cilat janë përgjegjëse për: - identifikimin e dëmeve, - verifikimin në terren, - miratimin e vlerës së kompensimit, - shpërndarjen e fondit sipas	
--	--	--	--	---	--

				procedurave ligjore. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile nuk administron emërtesa individuale të përfituesve, pasi kompensimet kryhen përmes fondeve të kushtëzuara të deleguara tek njësitë vendore sipas përcaktimeve në ligjin nr. 45, datë 18.7.2019 “Për Mbrojtjen Civile”. Për marrjen e listave të detajuara nominale të familjeve përfituese, është e nevojshme t’i drejtoheni zyrtarisht secilës bashki, në përputhje me legjislacionin për transparencën dhe mbrojtjen e të dhënave personale. 6. Cila t janë bashkitë që kanë pasur më shumë rastet e të fam	
--	--	--	--	--	--

				iljev e të dë mtu ara? Numri i familjeve të dëmtuara dhe përfituese nga fondi i emergjencave civile ndryshon çdo vit, në varësi të intensitetit dhe shpërndarjes gjeografike të fatkeqësive natyrore (tërmete, përmbytje, zjarre, rrëshqitje dherash etj.). Bazuar në të dhënat e përmbledhura nga proceset e kompensimit për vitet 2021–2024, bashkitë që tradicionalisht kanë raportuar numrin më të lartë të rasteve të dëmeve janë ato që ndodhen në zona me risk të lartë natyror, përfshirë: • Bashkia Shkodër – për shkak të përmbytjeve; • Bashkia Durrës – dëme të lidhura me pasgoditjet dhe efektet e tërmetit; • Bashkia Lezhë – përmbytje dhe zjarre në pyje; • Bashkia v Vlorë – zjarre dhe	
--	--	--	--	--	--

				përmbytje sezonale; • Bashkia Fier – përmbytje në zonat fushore dhe zjarre në pyje; Duke ju falenderuar për interesimin, nqelemi në dispozicionin tuaj për cdo paqartësi. Faleminderit		
2						
3						